



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 10 shkurt 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për Zgjatjen e Afatit

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtësit të viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të nenit 40(6)(h) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 9(5) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), merr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykues urdhëroi Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") të dorëzonte listën e 12 dëshmitarëve të parë të cilët synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjyq, ose të dëshmitarëve që do të japin dëshmi brenda tri javëve të para të gjykimit, cilado listë të ishte më e gjata.¹
2. Më të njëjtën datë, Trupi Gjykues urdhëroi Mbrojtësin e Viktimave ndër të tjera që, brenda datës 3 shkurt 2023, të informonte Trupin Gjykues, palët dhe pjesëmarrësit lidhur me synimin për t'i bërë pyetje ndonjërit prej 12 dëshmitarëve të parë të ZPS-së dhe, në qoftë se po, për kohëzgjatjen e parashikuar të pyetjeve.²
3. ZPS-ja ia vuri në dispozicion Mbrojtësit të Viktimave listën e 12 dëshmitarëve të parë më 1 shkurt 2023.³
4. Më 3 shkurt 2023, Mbrojtësi i Viktimave njoftoi për synimin e tij për t'u bërë pyetje dy dëshmitarëve të ZPS-së dhe gjithashtu kërkoi zgjatje të afatit deri më datën 13 shkurt 2023 për të parashtruar njoftim plotësues në lidhje me një dëshmitar tjetër ("Kërkesa").⁴
5. Më 6 shkurt 2023, Trupi Gjykues, me postë elektronike, urdhëroi palët të dorëzonin përgjigje, nëse kishin, ndaj Kërkesës brenda datës 8 shkurt 2023. Mbrojtja e Hashim Thaçit dorëzoi parashtrime mbi mënyrën e lejueshme të bërjes

¹ Transkripti, 16 dhjetor 2022, f. 1773, rreshtat 9-13 (urdhri i tretë gojor).

² Transkripti, 16 dhjetor 2022, f. 1774, rreshtat 2-22 (urdhri i tretë gojor).

³ F01243, *Parashtrim prej Prokurorisë i Listës së 12 Dëshmitarëve të Parë dhe Informacionit Shoqërues me Shtojcën 1 Konfidenciale*, 1 shkurt 2023, me Shtojcën 1, konfidenciale (F01243/A01).

⁴ F01253, *Mbrojtësi i Viktimave, Njoftim prej Mbrojtësit të Viktimave i Synimit për t'u Bërë Pyetje Dëshmitarëve dhe Kërkesë për Zgjatjen e Afatit për Parashtrimin e Njoftimit të Mëtejshëm*, 3 shkurt 2023, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 6 shkurt 2023 (F01253/RED).

së pyetjeve nga ana e Mbrojtësit të Viktimave (“Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit”).⁵ Asnjëra palë nuk dorëzoi parashtrime ku të kundërshtonte kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për zgjatje të afatit për dorëzimin e njoftimit plotësues.

6. Më 9 shkurt 2023, Mbrojtësi i Viktimave parashtrroi kërkesë për leje për t’iu kundërpërgjigjur Parashtrimeve të Mbrojtjes së Thaçit.⁶

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Në bazë të rregullës 9(5)(a), në qoftë se i jepen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, trupi gjykues mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej Rregullores apo prej trupit gjykues.

III. DISKUTIM

8. Trupi Gjykues konstaton se Mbrojtësi i Viktimave ka dhënë arsye të vlefshme, siç e kërkon rregulla 9(5)(a), për zgjatje të afatit, duke pasur parasysh se është një viktimë pjesëmarrëse shtesë që i është drejtuar vetëm kohët e fundit Mbrojtësit të Viktimave me pyetje të mundshme për t’ia bërë një dëshmitari. Trupi Gjykues gjithashtu gjykon se afati i propozuar në Kërkesë, d.m.th. data 13 shkurt 2023, është i arsyeshëm në bazë të rrethanave.

9. Trupi Gjykues vëren se Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit nuk i përgjigjen Kërkesës por vetëm sa ngrenë çështje lidhur me formën e pyetjeve që Mbrojtësi i Viktimave lejohet t’ua bëjë dëshmitarëve. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues vlerëson se nuk është e nevojshme që Mbrojtësi i Viktimave të kërkojë leje për t’u kundërpërgjigjur, siç ka vepruar. Në këto rrethana, Trupi Gjykues e gjykon të përshtatshme t’i lejojë Mbrojtësit të Viktimave të bëjë parashtrime gojarisht për këtë pikë gjatë konferencës së ZPS-së të caktuar për datën 15 shkurt 2023.

⁵ F01267, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Njoftimit prej Mbrojtësit të Viktimave të Synimit për t’u Bërë Pyetje Dëshmitarëve dhe Kërkesës për Zgjatjen e Afatit për Parashtrimin e Njoftimit të Mëtejshëm*, 8 shkurt 2023, konfidenciale.

⁶ F01270, Mbrojtësi i Viktimave, *Kërkesë e Mbrojtësit të Viktimave për Leje për Kundërpërgjigje ndaj Parashtrimin F01267 të Mbrojtjes së Thaçit*, 9 shkurt 2023, konfidenciale.

IV. VENDIMI

10. Për arsytet e lartpërmendura, Trupi Gjykses e **MIRATON** Kërkesën.

/nëshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E premtë, 10 shkurt 2023

Hagë, Holandë.